

Titulli i projektit: Përmirësimi i konservimit të bimëve prioritare në zonën ndërkufitare – Conse-pp

Partnerë të projektit: Instituti për përzgjedhjen e bimëve dhe resurset gjenetike (Partner Lider), Komuna Termi (PP2), Komuna Debarcë (PP3), Ndërmarrja publike për menaxhimin dhe mbrojtjen e zonës me shumë qëllime - JASEN (PP4), Fakulteti për shkencë të pylltarisë, peizazh arkitekturor dhe eko-Inxhinieri - HANS EM, Universiteti “Shën. Kiril dhe Metodij” në Shkup (PP5)

Projekti është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse në Programin INTERREG IPA CBC "Greqi - Republika e Maqedonisë së Veriut 2014-2020"

Me krenari deklarojmë se projekti "Përmirësimi i konservimit të bimëve prioritare në zonën ndërkufitare - Conse-pp" po hyn në fazën përfundimtare të zbatimit. Qëllimi kryesor i projektit është Mbrojtja dhe konservimi e specieve të rrezikuara dhe llojeve autoktone të florës në zonën ndërkufitare, e cila do të arrihet përmes prioritizimit dhe konservimit të specieve të rrezikuara të florës, nëpërmjet zhvillimit të strukturave të konservimit duke përfshirë edhe aplikacionet digjitale dhe infrastrukturën, si dhe nëpërmjet ngritjes së vetëdijes me qëllim që të fitohet një kuptim më i gjerë i rëndësisë së specieve individuale të florës dhe biodiversitetit të tyre. Në këtë kontekst, projekti publikon se Komuna e Debrçës është në fazën përfundimtare të rindërtimit të një qendre ekspozimi për të prezantuar florën lokale rreth Belçishko blato (Foto 1), Ndërmarrja Publike për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Zonës me Shumë Qëllime - JASEN implementoi një sistem për zbulim të hershëm të zjarrit me qëllim parandalimin e zjarrit dhe mbrojtjen e biodiversitetit (Foto 2), ndërsa ekspertët nga Fakulteti i shkencave të Pylltarisë, Arkitekturës së Peizazhit dhe Eko-Inxhinierisë - HANS EM, mblodhën më shumë se 114 specie bimore dhe i përgatitën ato për shumim të mëtejshëm (Foto 3). Të gjitha këto aktivitete janë pjesë e zhvillimit të masave të ruajtjes dhe infrastrukturës së ruajtjes me qëllim të mbrojtjes së biodiversitetit në zonën ndërkufitare.



1. Komuna Debarcë



2. JASEN



3. Fakulteti për shkencë të pylltarisë, peizazh arkitekturor dhe eko-Inxhinieri - HANS EM

